



RAPORT I DALË NGA SEANCA DËGJIMORE ME MOSTRËN PËRFAQËSUESE TË STUDENTËVE

Me qëllim të rritjes së cilësisë së brendshme të Fakultetit Juridik të Kolegjit UBT, Dekani i Fakultetit Juridik më 26.02.2021 ka mbajtur një seancë dëgjimore me mostrën përfaqësuese të studentëve nga secili vit i nivelit bachelor dhe nga programet master, në të cilën mostër kanë marrë pjesë studentët me arritje të lartë dhe ata me arritje më të ulët. Seancat dëgjimore të tilla mbahen me qëllim të identifikimit të praktikave të mira të mësimnxënies të cilat i ndjekin studentët me arritje të lartë në mënyrë që ato të transferohen tek studentët që ngecin. Gjithashtu qëllimi i seancës dëgjimore është që të identifikohen sfidat në procesin e mësimnxënies nga ana e studentëve që ngecin në mënyrë që të gjenden metoda dhe forma të mësimdhënies dhe përkrahjes për studentët që ngecin.

Sa i përket praktikave të mira të mësimnxënies, shumica e respondentëve nga rradhët e studentëve me arritje optimale konkluduan si në vijim:

- Pas ligjëratis ata menjëherë bëjnë përsëritje duke përdorur formën e Pyetjeve dhe Përgjigjeve (Frequently Asked Question) për temat e rëndësishme të prekura gjatë secilës ligjëratë;
- Praktikimi i mësimit grupor ndërmjet të studentëve;
- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime. Përqëndrimi i vëmendjes në ligjërata dhe aktivitet. Pjesëmarrja në të gjitha ushtrimet. Mësimi sistematik dhe konsistent.

Sa i përket formave me të cilat studentët mundën të përmirësojnë edhe më shumë mësimnxënien shumica e respondentëve të dalë nga seancat dëgjimore konkluduan si në vijim:

- Përfshirja e më shumë rasteve të studimit si formë e mësimdhënies por edhe mësimnxënies;
- Madhësia, pesha dhe numri i faqeve të punimeve seminarike të bëhet sipas një shkalle varësisht nga pesha e punimit seminarik në kuadër të ngarkesës së lëndës me përqindje e paraparë me planprogramin e lëndës;
- Përfshirja e një forme konsistente për vlerësimin e punimeve seminarike e njëjtë ose e ngjashme për të gjithë profesorët varësisht nga lloji i punimit seminarik (ese, rishikim i literaturës, hulumtim konceptual ose hulumtim empirik);

- Organizimi më efikas i orarit të ligjëratave gjatë pandemisë duke lënë më pak zbratësira kohore ndërmjet ligjëratave veçanërisht në nivelin bachelor, për të gjitha ligjëratat që mbahen në formë fizike;
- Futja e më shumë projekteve grupore për shkak se mësimi grupor është treguar efektiv, në të cilat grupe do të përfshiheshin edhe studentët që ngecin në formë proporcionale;
- Ulja në minimum e anulimeve të ligjëratave nga ana e stafit të caktuar;
- Rritja e interesit të studentëve në ligjëratat veçanërisht online nëpërmjet të videove, dokumentareve, mini kuizeve në mënyrë që të zgjohet kureshtja e studentëve gjatë ligjëratave online;
- Një pjesë e stafit akademik duhet të më inovativ në zgjimin e interaksionit në ligjëratat online duke ngritur pyetje diskutuese në klasë në vend se të përqëndrohet vetëm në ligjërime nga sllajdet;
- Disa nga lëndët janë të ndara profesorëve joadekuat të cilët nuk kanë specializimin e ngushtë për ato lëndë. Gjatë planifikimit për vitin e ardhshëm do të duhej që ngarkesa e njëtrajtshme e stafit të merret parasysh dhe gjithashtu vetëm stafi me specializim në atë fushë të jetë bartës i lëndës;
- Në provimet me pyetje esejike disa nga profesorët kërkojnë që përgjigjet të jenë përmendësh siç kanë kërkuar ata. Liria akademike e të shprehurit nga ana e studentëve të konceptit që e shpjegojnë të inkurajohet dhe të vlerësohet në formë konsistente;

REKOMANDIME:

- Përsëritja e shkurtër e elementeve kryesore të ligjëratës së kaluar nga secili profesor në ligjëratën vijuese për të ndjekur (follow-up) nivelin e mësimit konsistent;
- Futja e së paku 1 rasti të studimit në secilën lëndë si pjesë e ligjërimit dhe vlerësimit (ndërmjetëm, provimit final etj);
- Inkurajimi i lirisë akademike të studentëve në të shprehurit gjatë dhënies së përgjigjeve në pyetjet esejike në provimet me definicione dhe pyetje esejike;
- Standardizimi i madhësisë së punimeve seminarike bazuar në peshën e punimit seminarik të paraparë me planprogram;
- Standardizimi i kontrollës së punimeve seminarike në formë të rubrikave (Rubric Assessment);

Prof. Dr. Visar Hoxha





PROCESVERBAL

Mbajtur sot më datë 26.02.2021.


Me atë të të cilit Nënkomisioni për Cilësi i Fakultetit Juridik të Kolegjit Universitar UBT aprovon raportin e dalë nga seanca dëgjimore me një mostër përfaqësuese nga studentë, më datë 26.02.2021, takim i cili u zhvillua nga Dekani i fakultetit, Prof. Dr. Visar Hoxha.

Në seancën dëgjimore, morën pjesë studentë nga të gjitha vitet e studimit, bachelor dhe master, me arritje mësimore të larta dhe më të ulëta, të cilët diskutuan çështje të ndryshme lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien, ku çështjet më të veçuara prej studentëve, për të cilat ata kërkonin përmirësim, ishin në lidhje me:

- Përfshirjen më tepër të rasteve studimore,
- Përmirësimi i punimeve seminarike si hulumtime të mirëfillta dhe vlerësimin e tyre me më shumë impenjim dypalësh,
- Zhvillimi më cilësor i ligjëratave dhe frekuentim korrekt i tyre,
- Mësimi interaktiv,
- Lidhje e ngushtë mes lëndës dhe specializimeve të profesorit,
- Aplikimi nga ligjëruesit i formave të ndryshme të prezantimeve dhe lloje të ndryshme testimesh, esse dhe quize të shpeshta për kontroll njohurish ndaj studentëve, por edhe për të rritur interesin e tyre në mësimin online.

Në fund të seancës dëgjimore, Dekani, Prof. Dr. Visar Hoxha ka hartuar raportimin mbi konstatimet dhe rekomandimet e e takimit, ku Nënkomisioni për Sigurimin e Cilësisë nënshkruan miratimin e tij dhe merr angazhimin për plotësimin e çështjeve të diskutuara.

Kryetare e nënkomisionit: Dr. Njomëza Zejnullahu

Anëtar: Dr. Altin Maliqi 

Anëtare Studentja: Albana Kastrati